

RAPORTI TEKNIK

**RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES MESME BASHKUAR "LLAZAR KULI"
PERONDI + NDERTIM AMBIENTE NDIHMESE, BASHKIA KUCOVE**

INFORMACION I PERGJITHSHEM

- Vendndodhja e projektit Fshati Perondi –Njesia Administrative Perondi –Bashkia Kucove
- Objekti ekzistues eshte nje objekt 2 katesh ne gjendje shume te renduar teknike. Ky objekt ka probleme me plotësimin e kushteve më bazë të mësimdhënies pasi gjendja e mureve të shkollës, tualeteve, soletës etj, është shume e amortizuar. Konkretisht,tualetet janë ne një gjendje te renduar higjenike. Dyert dhe dritaret jane shume te vjetra dhe jashte cdo lloj funksioni.Rrjeti elektrik eshte shume i vjeter dhe perben rrezikshmeri për jetën e fëmijëve, madje ne klasa te ndryshme është thuajse jashtë funksionit. Kjo shkolle ka probleme gjithashtu me kullimin e ujërave të bardha dhe të zeza dhe lagështirën e cila është e përhershme edhe mungon ngrohja qendrore. Është e rëndësishme te theksojmë se qe nga koha e ndërtimit,kjo shkolle nuk është rikonstruktuar asnjëherë.

Pershkrim I gjendjes ekzistuese

Gjendja ekzistuese e objektit na paraqitet me problemet e meposhtme nga inspektimi:

- Demtim I suvase dhe bojes se fasades se jashtme
- Demtim I dyshemese se kateve me disnivele te pllakave dhe formimin e zonave me lageshtire.
- Amortizim I suvase se kalsave dhe ambienteve funksionale dhe dalja jashte funksionit e disa te tjerave (si palestra etj)
- Amortizim te sistemit te ngrohjes ne shkallen 50 %
- Demtim I tavaneve duke perfshire suvan, lageshti te tepert dhe ne disa klasa me rrezik renie.
- Demtim I tualeteve ne dysheme, sistemin e furnizimit me uje dhe ne funksionalitetin e tyre.
- Demtim I tavanit te katit te pare dhe catise e cila pikon duke depertuar edhe me shume lageshtira ne periudhe dimri.
- Demtime te konsiderueshme ne rrjetin e kanalizimeve dhe lokalizimin e ujrave te shiut.

Ne lidhje me punimet qe do te kryhen ju sqarojme si me poshte vijon:

- Shkolla ekzistuese do te rikonstruktohet teresisht.Jane parashikuar suvatime te reja , shtrese me pllaka , dyer dritare te reja ,sistemi elektrik dhe hidraulik ,si dhe do te ndërtohet sistemi ngrohjes qendrore me kaldaje.
- Ne fasaden e jashtme do te ketë veshje me polisterol si dhe do suvatohet me gip fiato.Mbulesa e objektit do te behet me cati per arsye te ndryshme si te temperatures por dhe eliminimit te lageshtires.
- Standardi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, në projektin
- Eshte parashikuar te ndertohet nje rampe ne hyrje te katit perdhe.



RAPORT TEKNIK

- Sipas situates aktuale ne pjesen e brendshme te shkolles eshte bere nje rikonstrukcion te plote konstruktiv i te gjitha ambjenteve lidhur se pari me rigrupimimin dhe riorganizimin e klasave, shtimin e tualeteve, rrjetit te jashtem dhe sistemimin e oborrit se bashku me hapsirat sportive.
- Riorganizimi I klasave eshte bere ne menyre te tille qe te merret parasysh rritje e numrit te nxenesve per klase dhe akomodimi I studenteve.
- Rikonstrukcion I plote I dyshemeve te kateve duke perfshire heqjen e pllakave ekzistuese dhe veshja me hidroizolim duke shmangur perseri problemet e lageshtise.
- Rikonstrukcion I plote I suvase se tavanave te cdo kati dhe ndertimi I tavanit me kartonxhes nen cati.
- Rikonstrukcion I plote I catise se shkolles ne perputhje me kerkesat per te shmangur problemet e shirave dhe lageshtise.
- Shkallet do te rivishen nga e para qe nga shtresa e llacit e deri ne shtrim me pllaka mermeri duke u pajisur me korimano ne njeran ane dhe tjetren me mbeshtetese ne murin me lartesi mbi 50 cm.
- Do te shtohen shkallet e emergjences.
- Fasada e jashtme do te vishet me sistem termoizolues.
- Sistemim I gjithe rrjetit te ujrave te shiut me ane te zgarave te shiut, tubacioneve, ulluqeve.
- Riorientim te tualeteve ne katin perdhe.
- Rrjeti I ri I sistemit te shkarkimit qe do lidhet me ate ekzistues.
- Sistemit te ri elektrik me ndricim me parametrat e duhura per secilin ambient.
- Duke pare gjendjen teper amortizuese te ngrohjes kemi bere ngrohjen e re me kaldaje qendrore me lende djegese me gas me eficence me rendiment te larte per konsum me te vogel te energjise.
- Dritaret jane mundesuar dritare termike me profile plastike me dopio xham termik me koeficient te ulet te transmetimit te energjis, gjithashtu xhami i jashtem do te jete transparent ne menyre qe te gjitha ambjentet te marrim ndricimin maksimal.

Ndertimi i godines shtese per ambjentet ndihmese

- Gjithashtu eshte parashikuar ndertimi i nje shtese anësore me 2kt e cila do te shtoje kapacitetet me 4 klase qe do te sherbejne si laborator informatike dhe shkenca natyre, dhe si biblioteke si dhe 2 tualete te reja.
- Duke marre shkas nga termeti i vitit 2019 qe goditi pjesen perendimore te Republikes se Shqiperise, sugjerojme qe te merret ne konsiderate nga ana e Perfituesit, kujdesi aspak i tepert per themelet, tabanin mbajtes te godines se re dhe konstruksionit me hekur dhe beton, pasi projekti zbatohet mbi formacione tokesore qe kerkojne nje raport gjeoteknik te sakte. Bazuar ne harten e re sizmike te territorit i Shqiperise konsiderohet me sizmicitet te larte, kujdesi dhe nevoja per staf te kualifikuar eshte e dukshme. Nga ana e Projektuesit sugjerohet qe te behet inspektimi ne vend si dhe te kryhen prova laboratorike ne te gjithe fazes



se zbatimit para se te fillojne themelet e objektit, ne menyre qe te percaktohet saktesisht se cfare lloj themelesh jane me te pershtatshme per zbatimin e kontrates me sukses.

Sistemimet e jashtme

- Pjesa e terreneve sportive do te shtohet me nje fushe basketbolli , vojlebolli si dhe nje fushe futbollit.
- Në sistemimin e oborrit janë parashikuar terren sportive, gjelbërim dhe sheshe rreshtimi.
- Nuk do te mungojne trotuaret , stolat dhe pemet qe do te mbillen per te shtuar gjelberimin.

Ndërtesa e re i përgjigjet nevojave aktuale si dhe perspektivave të zhvillimit të një shkolle në aspektin edukativ dhe në aspektin e mësimdhënies.


**Pergatiti: "DRICONS" SHPK
Ing. Vladimir TOPI**





Foto te Gjendjes Aktuale





















RENDERA

